



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

**PROGRAMI I LËNDËS**  
**Drejtimi: Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore**

**TITULLI I LËNDËS: SHKRIM AKADEMIK**

**Pedagogu:** Prof. Dr. Valentina Duka; Ma. Meliana Bregu

**Ngarkesa:** 6 ETCS (45 leksione dhe 15 seminare)

**Lloji i lëndës:** disiplinë e formimit të përgjithshëm (bazë)

**Programi i studimit:** Bachelor

**Viti/Semestri:** I/II

**EKSTRAKT:**

Lënda Shkrimi Akademik synon që t'u japë studentëve njohuri të themelore mbi mënyrat dhe metodat e shkrimit të punimeve akademike. Në qendër të këtij kursi do të jetë pajisja e studentëve me mjetet e duhura për të përballuar me sukses të gjitha kërkesat akademike të studimeve universitare në mënyrë që ata të mësojnë të shprehin qartë, të organizojnë si duhet mendimet e tyre, si dhe të nxisë tek ata mendimin kritik dhe gjykimin shkencor. Gjatë zhvillimit të kësaj lënde studentët do të njihen me llojet e burimeve që përdoren në punën kërkimore si dhe me rrugët që ndiqen për të mbledhur gjithë materialin e nevojshëm që shërben në shkrimin e punimeve akademike historike. Studentët do të përvetësojnë gjithashtu edhe metodat e analizimit dhe leximit të burimeve primare dhe sekondare në mënyrë që t'i përdorin ato sa më mirë gjatë dhe pas studimeve bachelor. Studentët do të mësojnë gjithashtu kriteret që përdoren për strukturimin e punimit dhe përdorimit me efikasitet të materialeve të grumbulluara prej tyre gjatë punës kërkimore.

## **TEMAT:**

**LEKSION 1.** Paraqitja e lëndës. Çfarë është shkrimi akademik.

**LEKSION 2.** Burimet e para. Çfarë janë ato, rëndësia dhe përdorimi i tyre.

**LEKSION 3.** Analiza e burimeve të para dhe kriteret e vlerësimit të tyre.

**LEKSION 4.** Arkivi, katalogu i fondeve dhe kërkimi i burimeve të para.

**LEKSION 5.** Burimet e dyta. Çfarë janë ato, rëndësia dhe përdorimi i tyre..

**LEKSION 6.** Analiza e burimeve të dyta dhe marrëdhënia tekst–autor.

**LEKSION 7.** Katalogjet dhe puna kërkimore në bibliotekë.

**LEKSION. 8.** Fondet burimore të institutve shkencore.

**LEKSION 9.** Përdorimi i shtypit. Rëndësia dhe kufizimet e tij.

**LEKSION 10.** Citimi dhe perifraximi.

**LEKSION 11.** Hartimi i strukturës paraprake.

**LEKSION 12.** Shkrimi i ‘Parathënies.’

**LEKSION 13.** Shkrimi i ‘Hyrjes.’

**LEKSION 14.** Trupi i punimit dhe argumenti kryesor.

**LEKSION 15.** Rishikimi i punimit dhe përmbledhja e ‘Përfundimeve.’

## **FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT**

**FREKUENTIMI:** 70% pranisë në seminare e domosdoshme.

*15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve*

### **KONTROLLI I VAZHDUESHËM:**

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

*25 % e notës përfundimtare.*

### **DETYRA E KURSIT:**

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

*20 % e notës përfundimtare*

### **KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:**

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

*40 % e notës përfundimtare*

**DETYRIMET E STUDENTËVE PËR LËNDËN**

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të semestrit)

**LITERATURA:**

1. Hoxha, Artan R. *Shkrimi Akademik për studentët e lëndëve historike*. (Leskion i pabotuar).
2. Eco, Umberto. *Si të shkruajmë një punim diplome*. (Tiranë: Dituria, 2005).
3. Zeneli, Bernard. *Shkrimi Akademik*. (Tiranë: UFO, 2006).
4. Musai, Bardhyl. *Të shkruajmë ese*. (Tiranë: Pegi, 2004).
5. Nishku, Majlinda. *Proçesi dhe shkrimet funksionale*. (Tiranë: Pegi, 2004).